



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.456/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË - Dhoma e Shkalles së Dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija - Ymeri, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës sh.a me seli në Prishtinë, ndaj debitorit “E...” NTSH në Prishtinë rr.”...” me pronar V.M., duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm CP.nr.1750/16 të datës 24.03.2021, me datën 21.11.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e debitorit “E...” NTSH në Prishtinë rr.”...” me pronar V.M., **ANULOHET** aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm CP.nr.1750/16 të datës 24.03.2021, dhe lënda i kthehet Gjykatës Komerciale – Dhomës së Shkalles së Parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e ankimuar CP.nr.1750/16 të datës 24.03.2021, e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit E...” NTSH në Prishtinë rr.”...” me pronar V.M., të paraqitur kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit të Përmbaruesit E.nr.333/12 të datës 15.06.2012 lëshuar nga Gjykata Ekonomike të Qarkut.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës përmbarimore dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të drejtë të gjendjes faktike, me propozim që gjykata e shkalles së dytë ankesën e debitorit ta aprovoj si të bazuar, aktvendimin e ankimuar ta prish dhe ta detyroj kreditorin që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës.

Dhoma e Shkalles së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 3,

paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturave me nr.6-12/11 me nr. tel. 610-414 dhe C.num. 550026121. Gjykata Ekonomike e Qarkut, sipas propozimit të kreditorit, me aktvendim nr.333/12 dt.15.06.2012, ka lejuar përmbartimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit t'i paguaj shumën prej 393.57 euro, me kamatën prej 3.5 % deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e përmbartimit.

Kundër urdhrit përmbartimor debitori ka paraqitur prapësim me datën 10.11.2017, me arsyetimin se kërkesat e kreditorit janë parashkruar duke iu referuar nenit 360 të LMD, propozon që gjykata ta aprovoj të bazuar prapësimin dhe ta detyroj kreditorin që ti paguaj shpenzimet procedurale.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori me datën 30.10.2020, me arsyetimin se kreditori si edhe debitori janë person juridik dhe propozimi për përmbartim është iniciuar kundër personit juridik e jo kundër personit fizik, andaj në këtë rast vjen në shprehje neni 355 i LMD që parasheh afatin tre vjeçar dhe jo neni 360 par.1 i LMD e cila rregullon afatin një vjeçar të parashkrimit, asnjë pretendim i debitorit nuk qëndron dhe nuk ka arsye nga neni 71 i LPP, në lidhje me vërtetimin se në rastin konkret vlen neni 355 i LMD kreditori ia bashkangjet kësaj përgjigje në prapësim aktvendimin e Gjykatës Themelore PP.nr.113/17 dt.30.10.2017 dhe aktvendimin e Gjykatës së Apelit AC.nr.2852/16 dt.25.07.2017. Propozimi për përmbartim përmban të gjitha të dhënat e nevojshme të përcaktuara me dispozitën e nenit 38 par.1 të LPP, nga rezulton se janë të pasakta pretendimet e debitorit se dokumenti i besueshëm nuk përmbush kushtet e përcaktuara ligjore. Propozon që gjykatat të refuzoj prapësimin e debitorit dhe të vazhdoj me përmbartimin e aktvendimit CP.nr.1750/16

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin CP.nr.1750/16 te datës 24.03.2021, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar. Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar ka theksuar se gjykata i ka analizuar shkresat e lëndës dhe ka vlerësuar se debitori nuk ka ofruar asnjë provë konform nenit 69 par.4 dhe neni 71 par.1 deri në 12 të LPP. Arsyeton se pretendimi i debitorit sa i përket parashkrimit të borxhit ndaj kreditorit e vlerëson si të pabazuar me arsyetimin se në rastin konkret afati i parashkrimit për kërkesat e arritura është përcaktuar neni 355 par.1 e LMD si afat tre vjeçar dhe se edhe po të vlenin dispozita e nenit 360 i LMD prap kërkesat e arritura për pagës të kreditorit të përmbartimit nuk do të ishin përfshirë nga Instituti i parashkrimit sepse propozimi i përmbartimit është paraqitur me datën 25.05.2012 ndërsa kërkesa e kreditorit është maturuar pas datës 25.07.2011 pra pa kaluar afati një vjeçar, andaj edhe ka vendos si në dispozitiv të aktvendimit.

Dhoma e shkallës së dytë qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i ankimuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së, si dhe me shkelje të nenit 29 paragrafi 1 pika 1.3, 43 paragrafi 1 dhe 4 të LPP-së.

Në këtë kontekst rezulton që vendimi i gjykatës së shkallës së parë të jetë i pabazuar dhe i paqartë e kjo lidhur me faktin se gjykata e shkallës së parë nuk ka analizuar saktë dhe drejtë gjendjen faktike përkitazi provave në lëndë. Gjykata e shkallës së dytë konstaton se propozimi për përmbarim nga kreditori është bërë në bazë të faturave nga të cilat rrjedh detyrimi i debitorit “E....” NTSH, me pronar V.M., me seli në rr.”....”....., nr.Cust e me vlerë prej 393.57.

Nga shkresat në lëndë del se subjekti “E....” NTSH ka numër Unik, nr. Biznesit 70701324 dhe nr. Fiskal, dhe në ARBK figuron e regjistruar me datën 19.10.2010 dhe me pronar M.Xh., adresa rr.”.... nr.15 në Prishtinë.

Po ashtu nga disa shkresa në lëndë përkatësisht regjistrimi në ARBK rezulton edhe subjekt tjetër “E.... 1” me pronar V.M., i rexhistruar në ARBK me datën 17.04.2012, me numër Unik, nr. Biznesit dhe nr.Fiskal.6....., me adresë rr.”.... në Prishtinë.

Marrë parasysh edhe pretendimin ankimor të personit V.M. i cili në propozimin për përmbarim figuron si pronar i subjektit “E....” NTSH me seli në rr.”....” në Prishtinë, i cili në ankesën e tij deklaron se është pronar i Subjektit “E.... 1” dhe se subjekti i tij nuk mund të ngarkohet me këto detyrime pasi faturat nga të cilat është caktuar përmbarimi janë dokumente të një periudhe kur “E....” nuk ka ekzistuar se vepruari dhe se subjekti “E.... ” është i regjistruar në ARBK me datën 18.04.2012 ndërsa detyrimet si në propozimin për përmbarim kanë të bëjnë për vitin 2011. Atëherë gjykata e shkallës së dytë vlerëson se, me qëllim të evitimit të këtyre dilemave, vlerësimit dhe verifikimit të shkresave të lëndës, analizimit të pretendimeve të palëve në procedurë, gjykata e shkallës së parë duhet ta këtë parasysh nenin 73 paragrafi 1 të LPP-së, i cili thotë, se: *“Gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përrjashtimisht Gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit. Gjykata do të njoftojë të gjitha palët për dëgjimin publik. Nëse Gjykata vendos të mbajë seancë dëgjimore publike, seanca dëgjimore do të mbahet brenda pesë (5) ditëve, kur kërkohet që përgjigjet ndaj prapësimit të pranohet nga gjykata”,* arsye këto nga të cilat rezulton se aktvendimi i ankimuar duhet të anulohet dhe çështja të kthehet në procedim të serishëm në gjykatën e shkallës së parë.

Në ri procedurë, gjykata e shkallës së parë duhet të ketë parasysh të gjeturat e gjykatës së shkallës së dytë, të vlerëson në mënyrë të drejtë dokumentin e besueshëm, të analizohen dhe verifikohen subjektet në shkresat e lëndës, të konstatohet saktë gjendja faktike përkitazi

shkresave në lëndë, ashtu që të caktoj seancë dëgjimore në kuptim të dispozitave të lartcekura, të ftohen palët ndërgjyqëse, të njëjtat të deklarohen rreth pretendimeve të tyre, e më pastaj varësisht nga të gjeturat edhe të vendos konform dispozitave ligjore duke marrë aktvendim të drejtë dhe të ligjshëm

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-DHOMA E SHKALLES SE DYTË
K.DH.SH.II nr.456/22, me datë 21.11.2022

Gjyqtarja,
Franciska Zhitija-Ymeri